



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 11 tetor 2021
Nr. ref.:RK 1861/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI55/20

Parashtrues

Arsim Biçaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev.nr. 359/2019
të Gjykatës Supreme, të 15 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arsim Biçaku nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev.nr.359/2019 të 15 janarit 2020 në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr. 3451/15] e Gjykatës së Apelit, të 24 qershorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza Juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 mars 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 6 shkurt 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 10 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr.KK-SP71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
10. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të emërohej kryesuese në Kolegjet shqyrtuese në rastet kur ajo ishte emëruar anëtare e Kolegjit, përfshirë rastin aktual.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr.KK-SP71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin Nr.K.SH.KI55/20, përmes së cilit e zëvendësoi Kryetaren e mëparshme, Arta Rama-Harizi, në rolin e saj si anëtare e Kolegjit shqyrtues me gjyqtarin Bajram Ljatifi.
13. Më 9 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune me Raiffeisen Bank Kosova (në tekstin e mëtejme: Banka Raiffeisen).
15. Më 20 tetor 2003, parashtruesi i kërkesës u njoftua nga Banka Raiffeisen se nga ajo datë punësimi i tij tek e njëjta do të përfundonte për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara në rregullore.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës në Bankën Raiffeisen ku kërkonte rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagesën e të ardhurave personale për periudhën nga kur i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.
17. Më 1 korrik 2004, Gjykata Komunale në Prizren (me Aktgjykimin C. nr. 769/03) e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi Bankën Raiffeisen që ta rikthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e mëparshëm të punës dhe të paguajë të ardhurat e tij personale për periudhën nga kur marrëdhënia e tij e punës u ndërpre, duke shpjeguar, *“e paditura vetëm ka konstatuar se punëtori ka munguar nga puna pa arsye dhe se ka bërë keqpërdorimin e detyrës së punës, pa e vërtetuar ne procedurë disiplinore mungesën e tij nga puna si dhe pa vërtetuar me prova te pakontestueshme se i njëjti ka bërë keqpërdorimin e detyrës së punës. Nga e tërë kjo, pa dyshim është vërtetuar se informimi i punëtorit nga ana e te paditurës, se paditësit i është ndërpre marrëdhënia punës, është i paqëndrueshëm, i pabazuar në rregullore dhe ligj dhe si i tillë nuk ka asnjë element qenësor te vendimit meritore që do të merrej nga komisioni disiplinor. Te gjitha konstatimet e të paditurës që i janë verë në barrë paditësit, ka qenë dashtë të jenë objekt shqyrtimi, vërtetimi dhe vlerësimi i komisionit disiplinor apo i organit të autorizuar te e paditura për të udhëhequr procedurë disiplinore me rastin e cenimit te detyrës së punës nga ana e punëtorit. Nga te sipër cekurat, gjykata ka vendosur si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi”*.
18. Në një datë të paspecifikuar, Banka Raiffeisen paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, “për

shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.

19. Më 9 dhjetor 2004, Gjykata e Qarkut në Prizren, përmes Vendimit (Ac.nr. 361/2004), e hodhi poshtë, si të paafatshme, ankesën e Bankës Raiffeisen.
20. Në një datë të paspecifikuar, Banka Raiffeisen paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut (Ac.nr. 361/2004) të datës 9 dhjetor 2004.
21. Më 24 Mars 2005, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit Rev.nr. 51/2005, e miratoi kërkesën për revizion të Bankës Raiffeisen dhe anuloi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, (Ac.nr. 361/2004) të 9 dhjetorit 2004, dhe ia ktheu çështjen gjykatës së njëjte për rivendosje, duke arsyetuar, *“Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është dorëzuar në Postën e Prishtinës me 18.10.2004 me dërgesë të porositur R.nr.38806. Ankesa e së paditurës është dorëzuar sipas nenit 112 par.4 të LPK, duke pasur parasysh se dita e fundit e dërgimit të ankesës ka qenë e diel, kur gjykata nuk punon, ashtu që afati i fundit i ankesës ka qenë 18.10.2004, që ishte ditë pune kur edhe është dorëzuar ankesa. Gjykata Supreme e Kosovës thënie e revizionit se aktvendimi i goditur është marre me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore i vlerësoi si të bazuara, ngase, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 366, par. 1 në lidhje me nenin 384, par.1 të LPK, kur e ka hedhur poshtë si të pasafatshme ankesën [...]”.*
22. Më 10 gusht 2005, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit (Ac.nr.164/2005) e miratoi ankesën e Bankës Raiffeisen, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, (C.nr.769/2003) të 1 korrikut 2004, dhe ia ktheu çështjen gjykatës së njëjte për rivendosje, duke theksuar se Gjykata Komunale në procedurën e përsëritur duhet të inspektojë kontratën e punës së lidhur midis Bankës Raiffeisen dhe parashtruesit të kërkesës dhe me rastin e marrjes së vendimeve të mbështetëta në Rregulloren e UMNÏK-ut për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë Nr. 2001/27 dhe të vlerësojë pajtueshmërinë e rregullores së punës së Bankës Raiffeisen me këtë Rregullore.
23. Më 26 tetor 2006, Gjykata Komunale në Prizren, në procedurën e përsëritur (me Aktgjykimin C.nr.681/05), miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe obligoi Bankën Raiffeisen ta kthejë parashtruesin e kërkesës në punë dhe ta kompensojë atë për të ardhurat e tij personale për periudhën nga kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës, duke shpjeguar, *“Sipas vlerësimit të gjykatës, Letërshkarkimi i të paditurës me të cilin paditësit iu është ndërpre marrëdhënia e punës, është i paligjshëm nga arsyeja se nuk është respektuar neni 5 pika 5.8; neni 9 pika 9.2 dhe 9.3, neni 11 pika 11.5 nënpika a) dhe b) i Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë; nuk është respektuar neni 112 dhe 113 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës i Kosovës si dhe nuk është zbatuar neni 45 e 59 i Ligjit mbi të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës, ngaqë edhe Rregullorja 2001/27, e rregullon përgjegjësinë disiplinore e materiale të të punësuarit sikurse këto dy ligjet e fundit, por në stilin tjetër, për q ‘gjë e paditura ka qenë e obliguar që këto t’i zbatoje”.*

24. Në një datë të paspecifikuar, Banka Raiffeisen parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Vendimit (Ac.nr.681/05) të Gjykatës Komunale në Prizren *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
25. Më 19 janar 2007, Gjykata e Qarkut në Prizren, përmes Aktgjykimit (Ac.nr. 523/2006), e hodhi poshtë ankesën e Raiffeisen Bank si të pabazuar dhe e mbështeti aktgjykimin e shkallës së parë në tërësi.
26. Në një datë të paspecifikuar, Banka Raiffeisen paraqiti një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren (Ac.nr.523/06) të 19 janarit 2007.
27. Më 10 korrik 2008, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit Rev.nr. 99/2007, miratoi kërkesën për revizion të Bankës Raiffeisen dhe anuloi Aktgjykimin (Ac. nr. 523/2006) të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 19 janarit 2007, si dhe Aktgjykimin (C.nr.681/2006) të Gjykatës Komunale në Prizren të 26 tetorit 2006, ndërsa çështjen ia ktheu gjykatës së shkallës së parë për rivendosje, duke urdhëruar, *“ Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim, të urdhërojë të paditurën që gjykatës t’i sjellë prova lidhur me sjelljen e paditësit në punë, në çfarë mënyre paditësi ka ndikuar në prishjen e raporteve ndër njerëzore, në çfarë mënyrë nuk e ka respektuar doracakun si dhe a i ka arsyetuar paditësi daljet nga puna siç thekson e paditura, të vërtetojë të gjitha faktet relevante që kanë të bëjnë me ekzistimin e shkeljeve të detyrave të punës për të cilat paditësit iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se a është zbatuar procedura e paraparë me dispozitat e sipër përmendura të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 dhe pas vlerësimit të drejtë të provave të marrë një vendim të ligjshëm”*.
28. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prizren, në procedurën e përsëritur (me Aktgjykimin C.nr.697/08), miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe obligoi Bankën Raiffeisen ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës parashtruesin e kërkesës dhe t’i kompensojë atij të ardhurat e tij personale, për periudhën kur marrëdhënia e tij e punësimit u ndërpre, duke shpjeguar, *“Gjykata ka vërtetuar se kundër Arsim Biçakut, këtu paditësit nuk është iniciuar me shkrim procedura e mirëfilltë disiplinore, me ç’ rast i punësuari do të njoftohej me shkrim dhe do t’i mundësohej dhënia e deklaratës, e drejta në mbrojtje sipas rregullores dhe ligjit dhe në bazë të provave të administruara dhe të vlerësuara nga komisioni disiplinor do të pasonte shpallja fajtor, apo lirimi i tij nga cenimi i detyrës së punës që i është vënë në barrë, e nëse do të shpallej fajtor, do t’i shqiptohej një masë disiplinore për shkak të cenimit të detyrës së punës të paraparë me rregullore dhe ligj, gjithëherë duke pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese në procedurë. Sipas Ligjit mbi bazat dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës, të aplikueshme në Kosovë, nëse punëtori mungon nga puna dhe për këtë nuk e njofton organin e autorizuar aty ku punon, personi i autorizuar mund të marrë vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa udhëhequr procedurë disiplinore. Nëse punëtori më pas prezanton arsye valide për mungesën nga*

puna, atëherë aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës revokohet, ndërsa ndaj punëtorit iniciohet procedura disiplinore për shkak të moslajmërimit me kohë që ka munguar nga puna dhe për këtë komisioni disiplinor mund t'ia shqiptojë masën disiplinore të paraparë me rregullore. Po ashtu nëse punëtori ngarkohet se ka bërë cenimin e detyrës së punës për shkak të keqpërdorimit të detyrës së punës, atëherë në procedure të rregullt disiplinore vërtetohet fajësia e tij dhe i shqiptohet masa përkatëse disiplinore konform rregullores dhe ligjit. Nga të sipër cekurat gjykata ka ardhë në përfundimin se e paditura me asgjë nuk ka vërtetuar fajësinë e punëtorit, këtu paditësit. Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura vetëm ka konstatuar se punëtori ka munguar nga puna pa arsye dhe ka bërë keqpërdorimin e detyrës së punës, pa e vërtetuar në procedurë disiplinore mungesën e tij nga puna si dha pa vërtetuar me prova të pakontestueshme se i njëjti ka bërë keqpërdorimin e detyrës së punës. Nga e tërë kjo, pa dyshim është vërtetuar se informimi i punëtorit nga ana e të paditurës, se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, është i paqëndrueshëm, i pabazuar në rregullore dhe ligj dhe si i tillë nuk ka asnjë element qenësor të vendimit meritorë që do të merrej nga komisioni disiplinor”.

29. Në një datë të paspecifikuar, Banka Raiffeisen si dhe parashtruesi i kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (Ac.nr.697/08) të 24 shtatorit 2010, “për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.
30. Më 10 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, përmes Aktvendimit (Ac.nr. 666/2010), miratoi ankesën e Bankës Raiffeisen si dhe ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, (C.nr.697/2008) të 24 shtatorit 2010, dhe ia ktheu çështjen gjykatës së njëjtë për rivendosje me shpjegimin, “gjykata e shkallës së parë nën pikën II. aprovon shumën prej 16.962,00 eurove në emër të kompensimit të ardhurave personale dhe në arsyetim të aktgjykimit thirret në raportin që ka dhënë eksperti i angazhuar B.I Me shikimin në ekspertizën e ekspertit B.I të datës 31.05.2010 rezulton se borxhi i të paditurës ndaj paditësit është në shumën e tërësishme prej 28.263,48 eurove. Nga kjo që u tha rezulton se aktgjykimi është i pakuptimtë dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit. Gjithashtu, në dispozitivin III të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë me shpenzimet e procedurës obligon të paditurin pa e cekur shumën e tërësishme dhe pa specifikuar në arsyetim se cilat shpenzime i aprovon përkatësisht me cilat shpenzime obligohet e paditura. Edhe kjo paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sepse në këtë pjesë aktgjykimin e bën të papërmbarueshëm. Njiherit edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë e posaçërisht faktet e kërkuara nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës me aktvendimin Rev.nr.99/2007, të datës 10.07.2008, ku gjykata e shkallës së parë ka pasur për detyrë që në rigjykim ta udhëzojë të paditurën që gjykatës t'i sjell prova lidhur me sjelljen e paditësit në punë, në çfarë mënyre paditësi ka ndikuar në prishjen e raporteve ndër njerëzore, në çfarë mënyre nuk e ka respektuar doracakun si dhe a i ka arsyetuar paditësi daljet nga puna gjatë orarit të punës sikur që thekson e paditura”.

31. Më 12 maj 2015, Gjykata Themelore në Prizren, në procedurën e përsëritur (me Aktgjykimin C.nr.899/12), miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi Bankën Raiffeisen ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës dhe t'ia paguajë të ardhurat e tij personale për periudhën kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës, duke arsyetuar: *“Gjykata gjatë gjyqimit të kësaj çështjeje ka marrë për bazë rekomandimet e Gjykatës Supreme e cila kërkon që të vërtetohen shkeljet detyrave të punës dhe sjellja e pahijshme. Mirëpo nga provat që pala e paditur i ka paraqitur gjatë seancave të shqyrtimit kryesor një pretendim i tillë nuk është vërtetuar e ashtu siç edhe vetë ka pohuar pala e paditur, kundër paditësit nuk është zhvilluar asnjë procedurë disiplinore paraprakisht. Mbi bazën e këtyre fakteve gjykata vendosi që të aprovon kërkesëpadinë. Sa i përket shumës së kompensimit të pagave të papaguara, gjykata i kushtoi besimin e plotë ekspertizës së ekspertit financiar, pasi që ajo ekspertize ishte e plotë dhe në asnjë konstatim të paraqitur në atë ekspertizë as pala paditëse e as ajo e paditur nuk paraqitën vërejtje. Gjykata lidhur me pretendimet e palës së paditur se paditësi ka dhënë dorëheqje, gjeti se njoftimi i paditësit që nuk do të punon deri sa nuk ka një bazë ligjore, nuk mund të konsiderohet si akt dorëheqje nga ana e punonjësit. Në rastin konkret pala paditëse me të drejtë ka vlerësuar se vazhdimi i mëtejme në vendin e punës, pas vendimit të Gjykatës Supreme i cili ka prishur vendimin e Gjykatës Komunale dhe atë të Qarkut për kthimin në punë nuk i ka mundësuar paditësit të vazhdon më tej në punë pa pasur një kontratë të re me palën e paditur. Rregullorja 2001/27 në nenin 11, parasheh shpërblyerjen e kontratës me marrëveshjen me shkrim në mes të punonjësit dhe punëdhënësit, mirëpo kërkohet që marrëveshja të jetë me shkrim e që në këtë rast, nuk ka ekzistuar një marrëveshje me shkrim. Andaj duke pasur parasysh se punët bankare mund të përcillen edhe me pasoja të rënda për punonjësin, gjykata vlerëson se paditësi nuk ka pasur bazë ligjore që të qëndron në atë vend të punës, pa pasur paraprakisht një kontratë të re. Në kuptim të nenit 452 lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të detyron palën e paditur në kompensimin e shpenzimeve procedurale duke i pranuar pjesërisht palës paditëse shumën prej 562,00 €, pasi që shuma e kërkuar prej 705,00€ e tëra nuk është specifikuar.”*
32. Në një datë të paspecifikuar, Banka Raiffeisen parashtroi ankesë ne Gjykatën e Apelit kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren (Ac.nr. 899/12) të 12 majit 2015 *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
33. Më 24 qershor 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjyqimit (Ac.nr. 3451/15), pjesërisht miratoi ankesën e Bankës Raiffeisen duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren (C. nr. 899/2012) të 12 majit 2015, në atë mënyrë që, përkundër parregullsive të vërtetuara në lejinin e parashtruesit të kërkesës, kërkesa e tij për t'u kthyer në vendin e tij të mëparshëm të punës u refuzua nga Gjykata Themelore. Ndërsa në pjesën që ka të bëjë me pagesën e të ardhurave të papaguara, shuma e gjykuar nga vendimi i shkallës së parë është zvogëluar.
34. Në arsyetimin e një pjese të Aktgjyqimit Gjykata e Apelit në lidhje me kthimin në vendin e mëparshëm të punës thekson: *“Në këtë rast paditësi e ka dorëzuar aktin e dorëheqjes nga marrëdhënia e punës, me pretekstin se me vendimin e*

Gjykatës Supreme, ishin anuluar vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta për kthimin në vendin e punës, dhe qëndrimi i mëtejshëm i paditësit në vendin e punës do të ishte pa bazë, por në vlerësimin e gjykatës ankimore kjo formë e justifikimit për aktin e dorëheqjes nuk e përlligj kërkesën e tij për kthim në vendin e punës. Nëse pas anulimit të vendimeve të instancave më të ulëta nga Gjykata Supreme, nuk do të kishte bazë ligjore për të qëndruar paditësi në marrëdhënien e punës, atëherë do të ishte e drejtë e të paditurës që referuar vendimit të Gjykatës Supreme ta njoftojë paditësin për ndërprerjen e kontratës së punës. Mbi këto konstatime Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për kthim në vendin e mëparshëm të punës është e pathemeltë”.

35. Në arsyetimin e një pjese të Aktgjykimit, Gjykata e Apelit, e cila ka të bëjë me përcaktimin e shumës së kompensimit monetar në lidhje me kompensimin e pagave thekson: *“ndryshohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë për kërkesën e paditësit lidhur me kompensimin e pagave, duke ia pranuar të njëjtit kompensimin vetëm në periudhën 10.10.2003 e deri më 27.03.2007, për shkak se e drejta për kompensimin e pagave për këtë periudhë derivon nga kundërligjshmëria e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Pas kësaj periudhe paditësi nuk ka të drejtë në kompensimin e pagave për shkak se i njëjti ishte kthyer në vendin e tij të punës dhe me dëshirë kishte lëshuar të njëjtin vend”.*
36. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (Ac.nr. 3451/15) të 24 qershorit 2019.
37. Më 15 janar 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Rev.nr. 359/2019, e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës dhe i mbështeti në tërësi aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe asaj të Apelit, duke arsyetuar: *“Thëniet e paditësit ne revizion se vendi i punës përkatësisht akt dorëheqja nuk është bere me vullnetin dhe dëshirën e tij, por për shkak te mos afrimit te kontratës se punës, mos krijimit te kushteve dhe bazës ligjore nga e paditura ka pasuar deklarata për ndërprerjen e marrëdhënies se punës, kjo gjykate i konsideron si te pabazuara dhe irelevante dhe nuk kane kurrfarë ndikimi në çfarëdo vendosje tjetër te kësaj çështjeje juridike. Paditësi fillimisht sa ka qenë në marrëdhënie pune ka pasur kontratën e punës me te paditurën te lidhur me date 26.6.2002 për kohë te pacaktuar. Me rastin e rikthimit ne pune kemi te bëjmë me vazhdimësi te punësimit përkatësisht kontratës se punës te lidhur me parë, e cila kontratë ishte e vlefshme me rastin e rikthimit, prandaj pretendimet e paditësit, se ndërprerjen e marrëdhënies se punës e ka ofruar për shkak te mungesës së bazës ligjore për punësim, kjo Gjykate nuk mund t'i konsideron si te bazuara. Për këto arsye u vlerësuan si te pabazuara pretendimet e paraqitura ne revizion përkitazi me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së dytë”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuarra i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.
39. Për sa i përket shkeljes së nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se marrë parasysh që nuk i ishte ofruar ndonjë kontratë e re nga Banka Raiffeisen deri më 26 janar 2009, ai u detyrua që më 29 janar 2009 ta njoftojë Bankën Raiffeisen për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, do të thotë për largimi nga puna sepse, bazuar në pretendimet e tij, *“ndërprerja e marrëdhënies së punës është logjike, sepse një njeriu i duhet kohë për t’u përgatitur për seancat gjyqësore. Pra, kjo është arsyeja që të punësuarit në banka nuk më largojnë nga puna, duke tentuar që të më bllokojnë plotësisht për të mbrojtur veten”*.
40. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ka pasur zbatim të gabuar të ligjit, më konkretisht, të *Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, neni 1, pika 1.2, Rregullores së UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës të Kosovës nr. 2001/27, neni 11, pika 11 janar, nën (e) si dhe të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës të RSFJ-së nr. 60/89, 42/90 të 31 dhjetorit 1989*.
41. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon *“Nuk më janë siguruar kushtet ligjore për mbrojtje (përfaqësuesi ligjor)”* në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi dorëzoi një deklaratë me shkrim nga avokatja Myrvete Çollaku.
42. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, (Ac.nr. 899/12) të 12 majit 2015.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
45. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47.
[Kërkesa individuale]

1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
2. *Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48.
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49.
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

46. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila e konteston një akt të organit publik, pasi që i ka shterur të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendon se i janë shkelur me vendimin e kontestuar, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të Ligjit si dhe e ka dorëzuar kërkesën e tij në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
47. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

48. Gjykata rikujton që kontesti ishte iniciuar si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës nga ana e Bankës Raiffeisen lidhur me të drejtën e kompensimit dhe kthimin në punë, pas disa procedurave dhe gjykimeve të përsëritura, së pari Gjykata Themelore miratoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës e më pas Gjykata e Apelit vërtetoi vendimin e shkallës së parë me disa korrigjime të caktuara, sepse ajo konsideroi që parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar Bankën Raiffeisen në një moment të caktuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pas asaj date parashtruesi i kërkesës nuk kishte të drejtën e kompensimit për të ardhurat (pagën) e humbur. Konkluzionet e këtyre gjykatave, pas parashtrimit të revizionit nga ana e parashtruesit të kërkesës, u miratuan nga Gjykata Supreme, e cila në thelb theksoi se me rastin e kthimit në punë, bëhet fjalë për vazhdimësi të punësimit, d.m.th. kontrata e punësimit e lidhur më parë, është e vlefshme me rastin e kthimit, prandaj

pretendimet e paditësit se ndërprerja e marrëdhënies së punës shkakton mungesën e bazës ligjore për punësim, Gjykata Supreme i konsideron si të pabazuara.

49. Prandaj, esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përmbledhet në: (i) pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës dhe (ii) pretendime për aplikimin e gabuar të ligjit dhe (iii) pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje.
50. Marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila e obligon Gjykatën që në bazë të nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara nga Kushtetuta në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së.

(i) Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës

51. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata thekson se në kuptim të kësaj të drejte konkrete, Kushtetuta parasheh standardin që përcakton garancitë dhe të drejtat për punë, mundësitë e punësimit dhe sigurimin e kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të lirë të profesionit, pa obligime detyruese. Këto të drejta rregullohen në mënyrë konkrete me ligjet në fuqi (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI46/15, parashtruese e kërkesës *Zejna Qosaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2015, paragrafi 26; dhe KI70/17, parashtrues i kërkesës *Rrahim Ramadani*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2018, paragrafi 48).
52. Gjykata thekson se neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës, thotë:

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”

53. Prandaj, dhe në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se e drejta për punë është e garantuar, për sa kohë që individ i vepron në përputhje me ligjet në fuqi që rregullojnë atë lëmi. Në procedurën në gjykata të rregullta, u konstatua që parashtruesi i kërkesës u largua nga puna në mënyrë të paligjshme, prandaj u konstatua se parashtruesi i kërkesës është larguar nga puna kundërligjshëm, për ç'arsye është urdhëruar kompensimi financiar për atë periudhë. Në një pjesë të procedurës, Banka Raiffeisen i ofroi parashtruesit të kërkesës kthimin në vendin e punës, por parashtruesi i kërkesës e refuzoi ofertën e tillë, prandaj Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme arsyetuan se pas kësaj periudhe, paditësi nuk kishte të drejtë në kompensim të pagës sepse i njëjti ishte kthyer në vendin e tij të punës dhe se u largua vullnetarisht nga vendi i njëjtë. Andaj, nuk ka dëshmi që parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar e drejta për të punuar në mënyrë të ligjshme në pajtim me rregulloret e brendshme.
54. Gjykata konsideron se vendimet e kontestuarra të gjykatave të rregullta nuk e pengojnë në asnjë mënyrë parashtruesin e kërkesës që të punojë ose ushtrojë

profesionin. Prandaj, nuk ka asgjë në pretendimet e parashtruesit të kërkesës që të arsyetojë përfundimin se të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës janë shkelur (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI136/14, si dhe KI42/17, parashtrues i kërkesës *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 53).

55. Gjykata thekson se është detyrim i parashtruesit të kërkesës që të mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe që të paraqesë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, i 5 dhjetorit 2013).
56. Prandaj, Gjykata këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, të cilat ai i ndërlidh me shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës, i hedh poshtë si të pabazuara, dhe duhet t'i deklarojë si të papranueshme në pajtim me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Pretendimet për aplikimin e gabuar të të drejtës materiale

(a) Parimet e përgjithshme në lidhje me aplikimin qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit

57. Gjykata, para se gjithash, thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtruese e kërkesës *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtruese e kërkesës *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., “Adem Jashari”*, aktvendimi i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues të kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
58. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç është theksuar më herët, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare t'i zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurojë apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-se, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39); shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, të cituar në tekstin më lartë, paragrafi 63).

59. Në këtë drejtim, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së Gjykata ka theksuar se, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur verën se një gjykatë ka “aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës (shih, rastet e GJEDNJ-së *Anheuser-Busch Inc. kunder Portugalit*, Aktgjykimi, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr.184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Pëduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler k. Italisë* [DHM], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin e cituar më lartë KI122/16, parashtrues i kërkesës *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; rastin KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, paragrafët 60 deri në 65; si dhe rastin KI121/19, parashtrues i kërkesës *Ipko Telecommunications*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 58; dhe KI195/ 20, parashtrues i kërkesës *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”*, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 97).

(b) Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

60. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës thirret në dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, Rregullores së UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës në Kosovës nr.2001/27 si dhe Ligjin mbi të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës të RSFJ-së nr. 60/89, 42/90 përkatësisht në faktin që Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, sipas mendimit të tij, e kanë aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar në vendimet e tyre.
61. Gjykata rikujton, para së gjithash, se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/27 kanë miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me korrigjime të caktuara në lidhje me vendimin e shkallës së parë, duke aplikuar me atë rast nenin 154 dhe nenin 155 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
62. Pas parashtrimit të ankesës nga ana e subjektit Banka Raiffeisen, Gjykata e Apelit (Aktgjykimit Ac. br. 3451/15) ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës themelore, duke arsyetuar si vijon:

“Sipas dispozitave në fuqi (ne kohen kur është iniciuar kontesti për anulim të vendimit) të rregullores së UNMIKUT 2001/27, neni 12, 14 dhe 15, një ndër të drejtat themelore të punëtorit është paga, në këtë rast e drejte themelore e paditësit është pagesa e pagave, të cilën paditësi nuk e ka realizuar për shkak të vendimit të kundërligjshëm të së paditurës me të cilin paditësit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, (kundërligjshmëria e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës është rrethanë e konfirmuar tani). Sipas dispozitës së nenit 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (LMD) parashihet se “kush i shkakton tjetrit demin ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se demin ka lindur pa fajin e tij”, ndërsa me dispozitën e nenit 158 parashihet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar demin me dashje apo nga pakujdesia”, ndërsa me

dispozitën e nenit 155 të LMD-se, parashihet se: “demi është pakësimi i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (demi i zakonshëm) dhe parandalim i shtimit të tyre (përfitimi i munguar) ...”. andaj mbi bazën e dispozitave të cituara Gjykata e Apelit vlerëson se aprovimi i pagave për periudhën 10.10.2003 e deri me datën 27.03.2007, ka baze ligjore, ndërsa pjesa tjetër është e pabazuar pasi që paditësit i është refuzuar kërkesa për kthim në punë.”

63. Gjykata Supreme (Aktgjykimit Rev.nr. 359/2019) e mbështeti plotësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe deklaroi:

“Gjykata Supreme e Kosovës, pranon si të drejte dhe të ligjshëm arsyetimin e gjykatës se shkallës se dyte për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit për kthim në punë si dhe kompensimin e pagave pas datës 27.3.2007. Kjo për arsye se paditësi me parashtrëse e njofton te paditurën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Baze për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është vet deklarata e paditësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ashtu që punëtorit i pushon marrëdhënia e punës (ipso iure). Pasi që baze për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është vet deklarata e punëtorit, efekti juridik i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk varet nga ajo se a është sjell vendimi apo jo për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Kjo për arsye se vendimi për ndërprerje të marrëdhënie të punës, sipas deklaratës së punëtorit, ka karakter deklarativ e jo konstituiv. Paditësi sa është udhëhequr procedura kontestimore përkatësisht me date 27.3.2007, para se të jepte dorëheqje me shkrim, ka qene kthyer në marrëdhënie pune duke realizuar dhe të ardhura, prandaj pas kësaj periudhe, paditësi nuk ka të drejte në kompensimin e pagave për shkak se i njëjti ishte kthyer në vendin e punës, të cilin pastaj e ka lëshuar me vete dëshirë.”

64. Bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duke iu referuar gjendjes faktike në rastin konkret, i shpjeguan parashtruesit të kërkesës se duke e paraqitur vullnetarisht dorëheqjen e tij ai më pas e humbi të drejtën e kompensimit të të ardhurave personale dhe të kthimit në punë.
65. Gjykata e Apelit më tej i shpjegoi parashtruesit të kërkesës (i) se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës ishte i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me nenet 12, 14 dhe 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/ prandaj, u miratua kompensimi i pagës për periudhën nga 10.10.2003 deri më 27.03. 2007; dhe (ii) ndërsa sa i përket periudhës pas kësaj dhe kthimit në vendin e mëparshëm të punës, parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë në kompensim të pagës sepse ai është kthyer në vendin e tij të punës dhe e ka lëshuar vullnetarisht vendin e njëjtë të punës.
66. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për shkak të aplikimit qartazi të gabuar ose arbitrar të ligjit janë të pabazuara në baza kushtetuese siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(iii) Pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje

67. Në fund, lidhur me pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje, Gjykata thekson se parashtuesi i kërkesës e pretendon këtë shkelje pa argumentuar ose arsyetuar këtë shkelje me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme. Pretendimet e parashtuesit të kërkesës në thelb bazohen në shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës dhe zbatimin e gabuar të ligjit, dhe këto pretendime tashmë janë vlerësuar nga Gjykata si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
68. Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një të drejte, pa një arsyetim të qartë dhe relevant se si ka ardhur deri tek shkelja e asaj të drejte, nuk është e mjaftueshme si argument për aktivizimin e mekanizmit të mbrojtjes të paraparë me Kushtetutë dhe Gjykatën si një institucion që kujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KIO2/18 parashtuese e kërkesës *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, paragrafi 36; KI95/19, parashtues i kërkesës *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31 dhe KI99/19, parashtuese e kërkesës *Persa Raičević*, Aktvendimi për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 52).
69. Qëndrimi i tillë i Gjykatës bazohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e së cilës pretendimet ose ankesat që janë të paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente dhe dëshmi deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; Pjesa I. Papranueshmëria bazuar në merita. A. Kërkesat qartazi të pabazuara; 4. Ankesat e pambështetura: mungesa e dëshmive, paragrafët 280 deri 283). Për më tepër, pretendimet e tilla që nuk deklarojnë në mënyrë adekuate shkeljen e pohuar janë gjithashtu të papranueshme sipas nenit 48 të Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (q) të rregullit 39 të Rregullores së punës, në bazë të të cilëve parashtuesve të kërkesës u kërkohet që të paraqesin në mënyrë të saktë dhe adekuate faktet dhe pretendimet e tyre për të drejtat dhe liritë themelore që pretendohet se u janë shkelur.
70. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron që parashtuesi i kërkesës nuk i ka qartësuar saktë faktet dhe pretendimet për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe se si rrjedhojë, këto pretendime duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundimi

71. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtuesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës së tij kushtetuese për punë dhe për të ushtruar profesionin për shkak të zbatimit qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit dhe shkeljes së të drejtës së tij për mbrojtje, përbëjnë pretendime që janë të pabazuara në baza kushtetuese.
72. Si përfundim, Gjykata konsideron që parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat para gjykatave të rregullta në çfarëdo mënyre përbënin shkelje kushtetuese të të drejtave të

garantuara me Kushtetutë, përkatësisht se ato i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.

73. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe e deklaron atë të papranueshme, në pajtim me nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 9 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani